



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 2.174/5 Prot.

Vlorë më, 30 . 11 . 2023

VENDIM

Nr. 59 datë 21.11.2023

PËR

MIRATIMIN E BASHKIMIT TË NJËSIVE BAZË TE FAKULTETIT TË
SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE TË UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORE

Në mbështetje nenit 25, 30 pika 6, 38 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresën nr.1922/3 prot, datë 17.11.2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.11.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore me shkresë 1922, prot datë 20.10.2023, për bashkimin e njësive bazë të Departamentit të Fizikës dhe Departamentit të Matematikës në njësine bazë të emërtuar: **Departamenti i Matematikës dhe Fizikës.**
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore të UV-së, Zëvendësrektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.
4. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije MAS.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Asoc.Xhiliola Agaraj (Shehu)

